REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 925/20
Datë/Datum. 12.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E OBILIQIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**OB614-20-4638-1-2-1**
Nr i brendshëm	**614 20 059 121**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me dru dhe pelet për institucionet komunale për ngrohje**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.P "AGONITI"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sheshi i Arbrit Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë — *10 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/295-181 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Misim Beqiri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

agonitintp@gmail.com

(Adresa elektronike)

12.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

N.T.P. "AGONITI" PRISHTINË

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 07.09.2020 Data e hapjes së ofertave dt. 05.10.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 29.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim me dt:03.11.2020 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt:06.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 2 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 65 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 4 i RRUOPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, AK-ja me dt. 29.10.2020 na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar, ndërsa e ka rekomanduar për kontratë **OE "AOME" SH.P.K. & TINI".**

Fillimisht ju sqarojmë se ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa me dt.02.11.2020 na është ofruar qasja në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, nga ana e AK-së.

Gjatë analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë ne e kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 7.1&7.2 ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa nr.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Pylltarisë se Kosovës për prerje dhe transport te drunjëve"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Dëshmia nr.3 Kopje e Licencës (e vlefshme)."*

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur pasi që nuk e kanë ofruar dëshminë e certifikatës ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, andaj edhe është dashur të shpallet si OE i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë ky OE. Ne në këtë aktivitet të prokurimit po diskriminohemi si OE i përgjegjshëm dhe një herit më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë dhe se të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se konzorciumi nuk e plotëson kërkesën për 60% të shumës së kërkuar punë të natyrës së njëjtë, sepse kontratën me nr. prok KKHE-029/2019-136 me titull "Furnizim me dru për shkolla (Ilaz Thaçi, Kështjella e Diturisë", Veli Ballazhi) nuk e ka të përfunduar dhe nuk ka ofruar referencë siç është kërkuar, madje kjo kontratë është e shkëputur nga ana e AK-së për shkak të mos përmbushjes. Andaj është për tu habitur se si AK-ja e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk e përmbush kërkesën e lartcekur, ku OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi se ka përfunduar furnizimet në vlerë prej:7,600.00 euro, ndërsa kontrata ka qenë e nënshkruar me vlerë prej:8,930.00 euro.

Gjithashtu pronari i OE Tini ka ofruar nj certifikatë nga Gjykata Themelore Prizren se nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndërsa qëllimi i lëshimit të kësaj certifikate shkruan se është **Punësimi,** pra kjo certifikatë nuk vlen sepse është për qëllime tjera dhe jo për tender, ashtu siç kërkohet dhe qashtu si i kanë ofruar kompanitë tjera e edhe vetë anëtari tjetër i konzorciumit të rekomanduar për kontratë.

Në lidhje me arsyet e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit, ju sqarojmë se këto arsye janë të pa bazuara dhe nuk qëndrojnë për faktet si në vijim:

Sa i përket arsyes së parë të AK-së ku e ka cekur se certifikata e prezantuar nga ne është pa afat, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së është tërësisht i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne e kemi ofruar certifikatën konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, e cila ka afat. Andaj kërkojmë nga ju që ta detyroni AK që ta analizoj edhe një herë dëshminë në lidhje me certifikatën të prezantuar nga ana jonë dhe pas analizimit në tërësi të nxjerr një vendim dhe jo të veprohet sipas hamendjeve të AK-së, pasi që shihet qartë se certifikata e prezantuar nga ne është plotësisht sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne e përmbushim kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë në lidhje me certifikatën e lartcekur, andaj edhe arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Në lidhje me arsyen e dytë të AK-së, ku e ka cekur se nuk kemi ofruar dëshmi në lidhje me qarkullimin bankar se kinse nuk e përmbushim kërkesën e FDT-së për qarkullim deri në 400,000.00 € në tri vitet e fundit, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazuar. Ky arsyetim i AK-së nuk qëndron sepse ne në ofertën tonë kemi prezantuar dëshmi të mjaftueshme të cilat tregon qartë se ne e kemi përmbushur kërkesën e FDT-së në lidhje me qarkullimin bankar të kompanisë tonë. Mirëpo AK-ja nuk i ka analizuar në tërësi të gjitha dëshmitë e prezantuara nga ne, ku me këtë veprim të AK-së po shihet qartë jo serioziteti në lidhje me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertës tonë. Në lidhje me këtë kërkesë AK-ja është dashur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, sepse ne gabimisht nuk i kemi futur me dosje të tenderit edhe dëshmitë e ATK-së për vitin 2018 dhe 2019.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se edhe ky arsyetim i AK-së për eliminimin e kompanisë tonë në lidhje me kërkesën për deklarata tatimore vjetore është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të AK-së se ne nuk i përmbushim kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pasi që siç e ka cekur AK-ja e keni prezantuar listën e kontratave mirëpo mungojnë dëshmitë. Ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është krejtësisht i pa bazuar, pasi që ne e plotësojmë kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Mirëpo nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me listën e kontratave të prezantuar nga ana jonë, ka mundur që në bazë të dispozitave të neni 59.2 dhe 72 të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me listën e kontratave, sepse ne listën e kontratave e kemi bashkangjitur, ndërsa sa i përket referencave që nuk i kemi bashkangjitur në bazë të nenit 39.8 të RRUOPP-së lejohet të kërkohen sqarime shtesë.

Neni 39.8 i RRUOPP-së e parasheh qartë se "Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara-Mund të kërkohen informata sqaruese. Mirëpo edhe pse dispozitat e lartcekura e sqarojnë qartë se mund të kërkohen sqarime shtesë, AK-ja nuk e ka bërë një veprim të tillë duke na diskriminuar haptas dhe një herit duke e favorizuar OE të rekomanduar për kontratë. Pasi që nëse do të na ishin kërkuar sqarimet nga ana e AK-së ne do ti kishim ofruar dëshmitë në detaje.

Po ashtu edhe në lidhje me arsyen tjetër të AK-së ku e ka cekur se ne e kemi paraqitur listën e mjeteve, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi se i posedon, ju sqarojmë se ky pretendim i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne i posedojmë mjetet e kërkuara në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Mirëpo nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me mjetet e prezantuara nga ne atëherë ka mundur të kërkoj sqarime shtesë në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë fare nga ana e AK-së, duke u munduar të na eliminojë nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat dhe jemi OE më i lirë se të gjithë OE ofertues në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se ne si OE i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo që nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me pretendimet e lartcekura ka mundur të kërkoj sqarime shtesë, mirëpo që nuk është bërë një veprim i tillë nga ana e saj. Andaj ky veprim i AK-së tregon qartë se ne po diskriminohemi në këtë aktivitet

të prokurimit nga ana e AK-së edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne me dt. 06.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Sa i përket arsyes së parë të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar ashtu siç edhe e kemi cekur më lartë ne në ofertë kemi prezantuar certifikatën e cila është ka afat dhe është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj arsyetimi AK-së është krejtësisht i pa bazuar.

Ndërsa në lidhje me arsyet tjera të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ju sqarojmë se të gjitha këto arsye janë të pa bazuara pasi që siç e kemi cekur më lartë nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me dëshmitë e prezantuara nga ne ka mundur të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 52.2 dhe 72 të LPP-së dhe gjithashtu konform nenit 39.8 të RRUOPP-së. Mirëpo që një veprim i tillë nga ana e AK-së nuk është bërë, fakt ky që tregon qartë diskriminimin e AK-së ndaj kompanisë tonë.

Po ashtu AK-ja në arsyen e refuzimin të kërkesës tonë për rishqyrtim, nuk e ka shqyrtuar fare pretendimin tonë ankimor në lidhje me OE të rekomanduar për kontratë fakt ky që tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Sepse nëse pretendimi ynë ankimor nuk do të ishte i bazuar atëherë AK-ja do të ofronte dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën në lidhje me certifikatën e lartcekur. Fakti se AK-ja nuk e ka shqyrtuar fare pretendimin tonë ankimor në lidhje me OE të rekomanduar për kontratë tregon qartë favorizimin që AK-ja po i bën OE të rekomanduar për kontratë, ku i njëjti edhe pse është i papërgjegjshëm dhe më i shtrenjtë se ne e ka rekomanduar për kontratë.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore, pasi që e ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim pa ofruar ndonjë dëshmi apo fakt ligjor.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezûlton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i **përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurohen që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE ***N.T.P "AGONITI"***
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 €.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*